



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 69

Prishtinë, më 8 qershor 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Teuta Hadri, Qamile Morina, Flora Brovina dhe Vezira Emrush.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit, Enis Halimi – zyrtar i fushës, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Liridon Selmani – KDI, Lejla Selimi – OSBE dhe Virtyt Ibrahimaga – ekspert.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25. 05. 2010,**
- 3. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për punën,**
- 4. Shqyrtimi i Propozimplanit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian,**
- 5. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25. 05. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

3. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit për punën

Sadik Idriz – Për këtë Projektligj do ta formojmë një grup pune më të gjerë, sepse është një ligj shumë i rëndësishëm. I tërë Komisioni mund të jetë pjesë e grupit të punës. Ndoshta një grup më i vogël do të ishte më efikas. Mjafton të jetë nga një përfaqësues i çdo grupi parlamentar.

Flora Brovina – Propozoi që përveç formimit të grupit të punës, të bëhet edhe një plan i punës si të punohet në amendamentimin e këtij ligji.

Sadik Idriz – Për këtë Projektligj do të organizojmë edhe dëgjim publik. Grupi i punës do ta bëjë edhe propozimin lidhur me të ftuarit në dëgjimin publik. Për këtë Projektligj do ta bëjmë edhe një vizitë pune në Slloveni dhe do të angazhojmë edhe ekspertë, të cilët do ta ndihmojnë punën e Komisionit. Do të bëjmë përpjekje që ligjin ta përfundojmë para pushimeve.

Nurishahe Hulaj – Ky ligj është shumë i rëndësishëm. Ligji, që të kryhet deri në fund të korrikut, kërkon angazhim shumë të madh. Sigurisht që Projektligji do të pësojë shumë ndryshime edhe në bazë të vërejtjeve, që janë dhënë edhe në seancë, sidomos sa i përket nenit 48, që ka të bëjë me pushimin e lehonisë.

Teuta Hadri – Edhe në seancë jam deklaruar se nuk pajtohem me nenin 48 të Projektligjit sa i përket pushimit të lehonisë. Qëndroj pranë propozimit tim të mëhershëm që pushimi i lehonisë të jetë 1 vit. Propozoj të jemi unik në qëndrimin tonë për pushimin e lehonisë. Nëse dëshirojmë t'i përkrahim grupet parlamentare, ta lëmë kështu si është. Nëse si Komision Funkcional do jemi më unikë dhe e mbrojmë qëndrimin e mëhershëm që pushimi i lehonisë të jetë 1 vit, do të jemi më të fuqishëm dhe do t'ia arrijmë.

Vezira Emrush - Duhet të angazhohemi më tepër që ta kemi një ligj të mirë të punës, sepse është një ligj i rëndësishëm dhe kemi kaos të vërtetë në punësim, në Kosovë. Duhet të shikojmë edhe në vendet e rajonit si e kanë të rregulluar pushimin e lehonisë që edhe ne ta rregullojmë ashtu.

Rita Hajzeraj – Dëshiroj të jem pjesë e grupit të punës dhe pajtohem që të bëjmë përpjekje ta përfundojmë amendamentimin e Projektligjit para pushimit. Pajtohem edhe me propozimin që pushimi i lehonisë të jetë 1 vit. Duhet të kontaktojmë edhe me ministrin edhe me FMN-në, në mënyrë që ta gjejmë një zgjidhje.

Gjylnaze Sylja – Komisioni ka përgjegjësi të madhe dhe duhet të punojë në interes të punëtorëve, kurse për implikimet buxhetore le të kujdeset Qeveria. Qeveria është dashur që ligjin ta punojë bashkërisht me ne. Këtë nuk e ka bërë. Tani ne do t'i mbrojmë qëndrimet që i kemi pasur edhe më herët, sidomos sa i përket pushimit të lehonisë. E përkrah propozimin ta bëjmë një punë intensive, që sa më parë ta përfundojmë amendamentimin.

Qamile Morina – Tha se tani, pas miratimit në parim nga seanca, barra bie mbi Komisionin, që ta amendantojë Projektligjin. Ne ta kryejmë punën tonë dhe ta rregullojmë nenin, në të cilin parashihet pushimi i lehonisë. Çështja financiare është kompetencë e Ministrisë së Financave. Ajo duhet t'i sigurojë mjetet. Duhet të punojmë që Projektligji të miratohet sa më shpejt dhe të mos dalim joserioz, se edhe ashtu mjaft është vonuar miratimi i tij.

Teuta Hadri – Propozoj që grupi i punës t'i ketë 5 anëtarë.

Flora Brovina – Tha se ligji që është miratuar në mandatin e kaluar, nuk është zbatuar për shkak të implikimeve buxhetore. Tani ta bëjmë një ligj në bashkëpunim me Qeverinë dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, në mënyrë që të zbatohet.

Pas diskutimeve, Komisioni e formoi grupin e punës për amendamentimin e Projektligjit të punës, në këtë përbërje:

Nurishahe Hulaj – kryesuese,

Flora Brovina – anëtare,

Gjylnaze Sylja – anëtare,

Rita Hajzeraj – anëtare,

Vezira Emrush – anëtare,

Qamile Morina – anëtare.

4. Shqyrtimi i Propozimit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian

Sadik Idriz – Tha se e kemi pranuar një përfundim nga Kryesia e Kuvendit. Sipas tij ngarkohen të gjitha komisionet parlamentare që brenda afatit të paraparë t’ia dërgojnë Komisionit për Integritet Evropian raportin për veprimet e ndërmarra në përmbushjen e detyrimeve lidhur me Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009. Komisioni në mbledhjen e radhës do ta ftojë ministrin e MPMS-së që të diskutohet lidhur me përmbushjen e pikave të parapara në këtë Raport, që janë të fushëveprimtarisë së MPMS-së.

Në takimin me ministrin do të njoftohemi edhe lidhur me hapat e ndërmarrë nga MPMS-ja për shpërbërjen e njëanshme të marrëveshjes nga Qeveria Zvicerane për pensionet e qytetarëve të Kosovës, që kanë punuar në Zvicër.

Flora Brovina – Propozoi që në takim të ftohen edhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Integritetit.

Sadik Idriz – Tha se Ambasada e Kosovës në Zvicër ka qenë shumë aktive, por kjo është kompetencë e MPMS-së, e cila duhet t’i fillojë diskutimet për arritjen e kësaj marrëveshjeje dhe t’i përmbushë kushtet që kërkohen nga Qeveria Zvicerane për nënshkrimin e saj.

Nurishahe Hulaj – Tha se Komisioni duhet ta përgatitë një raport tremujor me shkrim. Pas raportimit nga ministrat e ministrive përkatëse, t’ia përcjellë Komisionit për Integritet Evropian. Propozoi ta formojmë një grup pune, i cili do ta bënte draftimin e raportit.

Teuta Hadri – Pajtohet që Komisioni duhet të raportojë lidhur me punën që është bërë rreth përmbushjes së pikave të parapara në draftraportin për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009.

Gjylnaze Sylja – Pajtohet të ftohet ministri i MPMS-së, për të raportuar lidhur me përmbushjen e pikave të parapara në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009 dhe propozoi që ministri raportimit para Komisionit t’ia bashkëngjitë edhe raportin me shkrim.

Sa i përket marrëveshjes për pensionet, MPMS-ja duhet jo vetëm me Zvicrën, por edhe me të gjitha shtetet e tjera, ku kanë punuar shtetasit e Kosovës, të lidhë marrëveshje për pensionet.

Qamile Morina – Edhe më herët kam propozuar që nga dy anëtarë të Komisionit ta mbikëqyrin përmbushjen e pikave të parapara në këtë Raport dhe të realizojmë edhe vizita në

teren, në mënyrë që të kemi informata të plota dhe përfundimisht të dalim me një vlerësim real për përmbushjen e këtyre pikave. Propozoj që përveç ministrit të MPMS-së, t'i ftojme edhe përfaqësuesit e IOM-it. Propozimi i mysafirëve nga Zvicra ishte që përveç Qeverisë së Kosovës, të jetë garant në mbikëqyrjen e realizimit të asaj marrëveshjeje edhe një organizatë ndërkombëtare.

Rita Hajzeraj – Tha se një prej sfidave të Raportit të Progresit ka qenë edhe dialogu social, në të cilin bashkërisht me UNDP-në e kemi filluar hartimin e një dokumenti, i cili mund të merret si shtesë e ngritjes së dialogut social në Kosovë.

Sadik Idriz – Do ta ftojme ministrin e MPMS-së dhe do të kërkojmë edhe informata me shkrim rreth përmbushjes së pikave të parapara në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009. Gjithashtu do ta ftojme edhe ministrin e MSH-së. Pas informatave nga të dy ministrat do ta hartojmë edhe raportin për komisionin përkatës.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që për mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MPM-së , z. Nenad Rashiq, që të raportojë para Komisionit për:

- Shkëputjen e njëanshme të marrëveshjes nga Qeveria Zvicerane për pensionet e qytetarëve të Kosovës, që kanë punuar në Zvicër.

- Përmbushja e pikave nga Propozimplani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, nga fushëveprimtaria e Ministrisë së Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

5. Të ndryshme.

Sadik Idriz - Kemi një ftesë për pjesëmarrje të një anëtari të Komisionit, në një konferencë, që ka të bëjë me shëndetin riprodhues, në Bukuresht.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që në konferencë të marrë pjesë deputetja, Teuta Hadri.

Gjithashtu u diskutua që anëtarët e Komisionit ta bëjnë një vizitë pune në Slloveni, lidhur me Projektligjin e punës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz